



b3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 9063/1 prot.Vlorë, më 20.05. 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ 2026

PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË QË PËRFITONJË FAMILJET, BANESAT E TË CILAVE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I KANALIT TË UJËRAVE TË LARTA” VLORË.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1/b, neni 27 pika 1, neni 29 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesëve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

VENDOSI

- I. Të miratojë dhënien e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar për familjet, banesat e të cilave preken nga zbatimi i projektit “Rikonstruksion i kanalit të ujërave të larta”, Vlorë. Emrat sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
- II. Afati i përfitimit të bonusit të qirasë për familjet sipas pikës I. të këtij projektvendimi fillon nga momenti i lëshimit të banesës dhe nënshkrimit të marrëveshjes për përfitimin e trajtimit me Bashkinë Vlorë.
- III. Pagesa e qirasë do të rinovohet çdo vit nga data e përfitimit, sipas kontratës së qirasë dhe kushteve të strehimit që parashikohen në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social” të ndryshuar.
- IV. Efektet financiare të pikës I. të këtij vendimi do të mbulohen sipas pikës nr.2, të kreut II. të VKM Nr.409/2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesëve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”.

- V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.



KRYETAR

Brunilda Mersini

ME URDHËR DELEGIMI

NËNKRYETAR

Joljana Llanaj



Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Përbërja familjare	Sipërfaqja/m2	Shuma e bonusit lekë/muaj
1	Jetnor Mehmet Shehaj	5	80	30000
2	Rovena Zaim Petanaj	4	70	25000